# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "DUKA T2" SHPK

Ne baze te ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te" si dhe te ligjit 7973, date 26.07.1995 "Per koncesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe ne infrastrukture" si dhe ligjit 8527, date 23.09.1999 "Per privatizimin e hidrocentraleve vendore";
formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "DUKA T2 " SHPK e ortakut te vetem themelues HYSEN DUKA .

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 1

"DUKA T2 " SH.P.K. me ortakut te vetem HYSEN DUKA ,i biri i Muharemit dhe i Mejtes , lindur ne Diber me 1956 dhe banues ne Lezhe , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DUKA T2 " shpk eshte ne " Lagja Varosh , Pall. 150 Lezhe " . Ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare "DUKA T2 " SHPK shpk eshte mbi 10 vjet, me te drejte riperteritje.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "DUKA T2 " shpk eshte sa me poshte vijon:

1. Operator te prodhimit te energjise elektrike, prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te hidrocentraleve ekzistuese dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj, te kapaciteteve te vegjel e te mesem (nga 0,2-2,5MWA)
2. Transformim dhe shperndarje te energjise elektrike.
3. Ndertim-montim te impianteve te ndryshme elektrike e rrjet te tensioneve te ulet e te larte si dhe import eksport te makinerive dhe pajisjeve te kembimit per to .
4. Tregetim me shumice dhepakice,import eksport te artikujve te ndryshem industriale ,bujqesore,elektroshtepiake,ushqimore,konfeksione,farmaceutike,kozmetike,materiale ndertimi,hidrosanitare,hidraulike,kancelari, bar bufe , restorant , hoteleri, perpunim te lendes drusore , mobileri, sherbime te ndryshme ne fushen e transportit te mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashte vendit .

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

## KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themelor i shoqerise tregtare DUKA T2 " SHPK eshte 100.000 leke i investuar ne mase te plote prej Ortakut te vetem.

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te ndryshohet vetem me vendim te ortakut te saj te vetem.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 7

Shoqeria tregtare " DUKA T2 " shpk eshte prone e Ortakut te vetem te saj, i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise. Administrator i shoqerise do te jete HYSEN DUKA .

NENI 8

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise ortaku emeron e puneson administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetentat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht Ortakut te Vetem.

## MARREDHENIET E PUNES

NENI 9

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes.

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 10

Perfaqesimi i shoqerise tregtare " DUKA T2 " shpk i perket Ortakut te vetem te saj si dhe administratorit te saj z. HYSEN DUKA. Ne mungese te tij shoqeria administrohet nga perfaqesuesi ligjor me prokure te noterizuar vetem sipas tagreve te caktuara ne prokure.

## KONTROLLI I BRENDSHEM

NENI 11

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili eshte pergjegjes perpara kesaj shoqerie per qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregulle e detyres se tij.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 12

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

NENI 13

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 14

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku. Ne rast mbylljeje Ortaku i vetem vendos mbi menyrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.Ne rastin e likuidimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregtar i asaj gjykate.

## DISPOZITA TE TJERA

NENI 15

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga ortaku i saj.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
" DUKA T2 " SHPK
HYSEN DUKA